

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **612-26-3850-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Digjitalizimi në objektet shkollore (Digjitalizimi i procesit shkollor-Zhvillimi i softuerit shkollor , blerja e Smart Boards dhe time attendance për realizimin e procesit shkollore)- projekt tre vjecar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	ALLIANCE SH.P.K.
NUI	811302330
Adresa	Rr.Luan Haradinaj, Nr.Lok.130
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049717171
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Hetem Nika
Adresa elektronike	alliance.ks2024@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	14.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Digjitalizimi në objektet shkollore (Digjitalizimi i procesit shkollor-Zhvillimi i softuerit shkollor , blerja e Smart Boards dhe time attendance për realizimin e procesit shkollor)- projekt tre vjeçar

Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues (Komuna e Fushë Kosovës) të datës 17.07.2026 (I publikuar me dt. 20.07.2026) për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: 'Digjitalizimi në objektet shkollore (Digjitalizimi i procesit shkollor-Zhvillimi i softuerit shkollor, blerja e Smart Boards dhe time attendance për realizimin e procesit shkollor)- projekt tre vjeçar', me nr. prokurimit: 612-26-3850-1-1-1.

Ankesa paraqitet për shkak të shkeljes mbarëvajtëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP):

Shkelje e Nenit 7 (Trajtimi i Barabartë) dhe Nenit 28 (Specifikimet Teknike) përmes hartimit të specifikave teknike jo-proporcionale dhe diskriminuese që favorizojnë prodhues dhe operatorë të caktuar ekonomikë.

Shkelje e Nenit 108/A të LPP-së për shkak se AK ka vazhduar me hapjen e ofertave (me dt. 20.07.2026, ora 13:30) pa e pritur përfundimin e afateve ligjore ankimore dhe pezullimin e procedurës. Rjedhimisht, duke na pamundesuar edhe neve si OE - palë e interesuar të përgatisim ofertën dhe të marrim pjesë në Tender.

Njoftimi për kontratë është dërguar në e-prokurim me dt. 26.05.2026

Dt. Ankeses : 14.07.2026

Vendimi AK : 20.07.2026.

Hapja e Tenderëve : 20.07.2026. Ora: 13:30h

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Parashtrojmë këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) sepse përgjigja dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues (AK) me datë 17.07.2026 (i publikuar me dt. 20.07.2026 në e-prokurim) është tërësisht i pabarazuar, i paarsyetuar dhe formal. AK ka injoruar pretendimet tona thelbësore lidhur me diskriminimin teknik dhe kufizimin e konkurrencës:

1. Diskriminimi përmes Specifikave Teknike dhe Favorizimi i Brand-it/OE të paracaktuar (Shkelje e Nenit 7 & 28 të LPP-së):

Dosja e Tenderit përmban kërkesa teknike dhe softuerike jashtëzakonisht specifike të cilat, me gjithë deklarinimin formal të AK-së për 'ose ekuivalente', në praktikë janë kopjuar nga specifikimet e prodhuesit 'Smart Technologies' (Smart Boards) dhe zgjidhjeve softuerike të gatshme të konsorciumit pretendent për kontrat

1. Kosova Information Technology SH.A.

2. SolvIT SHPK (Reseller i autorizuar i SMART TECHNOLOGIES)

Kjo strukturë kërkesash krijon përparësi disproporcionale dhe pengesë artificiale për Operatorët tjerë Ekonomikë, duke cenuar parimin e konkurrencës së lirë.

2. Kriteret e Stafit dhe Kapaciteteve jo-proporcionale:

AK ka vendosur kërkesa tejet strikte dhe disproporcionale për stafin profesional (kërkimi simultan i Arkitektit të Sistemeve, Ekspertit të Sigurisë Kibernetike, 5 Zhvilluesve të Softuerit, Edukatorëve Trajnues dhe Teknikëve të certifikuar), me qëllim të skualifikimit të OE-ve me oferta ekuivalente teknologjike. AK ka dështuar të arsyetojë objektivisht pse këto specifikime janë të domosdoshme për objektin e kontratës.

3. Procedura e paligjshme e Hapjes së Ofertave (Shkelje e Nenit 108/A të LPP-së):
AK ka vazhduar me hapjen e ofertave me datë 20.07.2026 në orën 13:30, pa respektuar pezullimin automatik dhe afatet ligjore ankimore pas pranimit të vendimit për rishqyrtim. Ky veprim procedural ka pamundësuar përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës sonë në kushte të barabarta.

Kërkesa ndaj OSHP-së:

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të miratojë këtë ankesë si të bazuar, të anulojë Vendimin e AK-së të datës 17.07.2026 (i publikuar me dt.20.07.2026), të urdhërojë përmirësimin e Dosjes së Tenderit duke mënjanuar specifikimet diskriminuese dhe të kthejë procesin në rivlerësim/ridorëzim të ofertave.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP Nr.04/L-042 Qellimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7. Barazia në trajtim / jo-diskriminimi
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 27/A Ndarja e kontratave në Lote
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratë
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 60. Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 65 Provueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues me Vendimin e datës 17.07.2026 (i publikuar me dt. 20.07.2026) ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, duke pretenduar se specifikimet teknike janë të bazuara në nevoja funksionale dhe se vlen parimi “ose ekuivalente”. Ky arsyetim është i pamjaftueshëm, i përgjithësuar dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim

Publik.

Shkeljet kryesore:

1. Specifikimet teknike favorizojnë në mënyrë diskriminuese prodhuesin SMART Technologies (Shkelje e Nenit 28, Nenit 7 dhe Nenit 6 të LPP-së)

Dosja e Tenderit (Annex 1) përmban specifikime teknike që korrespondojnë një për një me modelin **SMART Board GX175** të prodhuesit **SMART Technologies**. Këto specifikime nuk janë funksione të përgjithshme standarde të industrisë, por karakteristika specifike/patentë të këtij prodhuesi:

-
- **Object Awareness™** – Funksion i patentuar nga SMART Technologies, ku sistemi dallon automatikisht midis lapsit (shkrim), gishtit (selektim/lëvizje) dhe dorës (fshirje) pa konfuzion. Ky funksion është i markuar zyrtarisht si “Object Awareness™” (shih Trademark List të SMART Technologies dhe specifikat e GX series). Asnjë prodhues tjetër nuk e ofron me të njëjtin emër dhe precizion të patentuar.
-
- **Magic Wand** – Mjet ekskluziv i **SMART Notebook software**-it që shndërron vizatimet e lira automatikisht në clip art. Ky funksion është pjesë integrale e ekosistemit SMART dhe nuk ekziston në të njëjtën formë te konkurrentët.
-
- **Integrim perfekt Desktop – Android – Cloud** me ruajtje reale brenda dokumentit (PowerPoint, PDF, Video, Browser).
-
- **Split Screen Overlay i avancuar** dhe **Remote Management i plotë** (administrim qendror i të gjitha tabelave – mesazhe, bllokim, instalim app, monitorim).

Këto funksione, së bashku me kërkesën për **Android EDLA Certified** (Android 14/15 me gjuhë shqipe) dhe software-in specifik SMART, krijojnë një profil produkti që plotësohet vetëm nga **SMART Board GX175**. Prodhuesit e tjerë (BenQ, Promethean, ViewSonic, Newline, Samsung) ofrojnë zgjidhje të ngjashme por jo identike në kombinim, gjë që në praktikë eliminon konkurrencën.

Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij nuk ka kryer asnjë analizë teknike krahasuese konkrete, por është kufizuar në pohime të përgjithshme pa prova. Kjo përbën shkelje të qartë të Nenit 28 LPP, i cili ndalon rreptësisht përdorimin e specifikimeve teknike që favorizojnë një prodhues ose model të caktuar, si dhe shkel parimin e proporcionalitetit (Neni 6) dhe barazinë në trajtim (Neni 7).

2. <https://www.smarttech.com/education/products/interactive-displays/gx-plus-series>
3. https://downloads.smarttech.com/media/sitecore/en/support/product/sbfpd/gx/specs/specssbidgxv4plusna.pdf?_gl=1*j0a788*_gcl_au*MTA2ODEyODc0My4xNzc5OTgwMDAx*_ga*MTI5MDI4NTY0LjE3NTY3OTc2Mjg.*_ga_659C3L7DXH*cze3ODQ4OTYxMTYkbzE4JGcxJHQxNzg0ODk2NjM1JGo0NyRsMCRoMA..
4. <https://www.smarttech.com/education> - (SOFTWARE)
5. <https://www.smarttech.com/education/products/software/smart-notebook>
6. <https://www.smarttech.com/education/products/software/smart-remote-management>
7. <https://www.smarttech.com/lumio>

TUTJE: Tani më pretendimet tona të dërguara edhe në kërkesn për Rishqyrtim te AK - se specifikat teknike janë të përpiluar në atë mënyrë që të i përshtaten vetëm një prodhuesi janë vërtetuar edhe me publikimin e "Procesverbalit i hapjes së Tenderit" - ku shohim qartë, grupin e OE, pretendent për kontratë :

GOE: KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A. & SolvIT SH.P.K.

SolvIT SH.P.K. - është i vetmi OE - i autorizuar nga SMART TECHNOLOGY për shitje, servisim, dhe montim të SMART Board-ve të SMART Technologies. Kete e gjeni edhe ne webfaqen zyrtare te SMART TECHNOLOGIES dhe në webfaqen e OE - SolvIT, si dhe në shumë postime marketingu në profilin zyrtarë të OE në Facebook.

1. <https://solvit-ks.com/product/smartboard-gx-series>
2. <https://www.facebook.com/SolvitKs/videos/collaborate-naturally-with-smart-technologiespër-më-shumë-vizito-wwwsolvit-kscom/783043375157762/>
3. <https://www.facebook.com/share/r/196CZ5JnCR/>
4. <https://www.facebook.com/share/v/1Crp3mM1Ae/>

SMART Board GX V4 Plus (75") i plotëson specifikat e tenderit, më poshtë është

krahasimi pikë për pikë i specifikave teknike hardware, sistemit operativ dhe softuerit:

1. Krahasimi i Hardware-it dhe Portave (GX V4 Plus vs. Tenderi)

Parametri / Specifika	Kërkesa e Tenderit	SMART Board GX V4 Plus (75")	Statusi / Përputhshmëria
Madhësia & Ekрани	Min. 75", LED, 4K UHD, Low Blue Light	75", 4K UHD, Zero- Bonded, Low Blue Light	I PLOTËSUAR
Sistemi Operativ (OS)	Android 14 ose 15, Google EDLA Certified	Android 14 me Google EDLA Certification	I PLOTËSUAR
Procesori (CPU)	Octa-Core	Octa-Core	I PLOTËSUAR
RAM Memoria	Min. 8GB DDR4	8 GB DDR4	I PLOTËSUAR
Storage (SSD/Internal)	Min. 64GB mbështetje microSD deri 512GB	64 GB Internal Storage Slot microSD	I PLOTËSUAR
Multitouch (Pikat)	Min. 40 pikat touch	40 pika touch simultane (Android & Windows)	I PLOTËSUAR
Mbrojtja e Xhamit	Anti-Glare, Anti-Fingerprint	Anti-Glare, Anti- Fingerprint, Toughened Glass	I PLOTËSUAR
Refresh Rate & Frame Rate	50/60Hz, Frame rate 120Hz/200Hz	60Hz Display Refresh Rate	I PLOTËSUAR
Sensori i Dritës	Ambient Light Sensor	Ambient Light Sensor i integruar	I PLOTËSUAR
Saktësia (Accuracy)	1mm (Palm Rejection, Object Recognition)	±1mm, Palm Rejection & Smart Object Detection	I PLOTËSUAR
Zëri (Audio)	Integrated 2 x 20W	2 x 20W Front-facing Speakers	I PLOTËSUAR
Rrjeti & Bluetooth	Wi-Fi 6 (Dual Band, AP, WPA3), Bluetooth 5.2	Wi-Fi 6 (WPA3 Enterprise support), Bluetooth 5.2	I PLOTËSUAR
Konsumi i Energjisë	Standby Mode <0.3W, Operating ~85W (±10%)	Standby <0.5W, Energy Star Certified	I PLOTËSUAR
Porta USB-C	2 x USB Type-C (njëra prej tyre USB-C 65W)	USB-C me Power Delivery deri 65W/100W	I PLOTËSUAR
Portat e tjera (pa OPS)	4x USB 3.2, 2x USB 3.0, 2x HDMI IN, 1x HDMI Out, DP, VGA, RJ45 In/Out, OPS 90W	HDMI 2.0 In/Out, DisplayPort, VGA, USB 3.2, Dual RJ45 Gigabit, OPS Slot 100W	I PLOTËSUAR
Mbajtësja e Lapave	Mbajtëse magnetike për 2 lapsa	Lapsa magnetikë me ngjitje në kornizë (2x Pens)	I PLOTËSUAR
Garancia & Certifikimet	3 deri 5 vite, ENERGY STAR, CE, RoHS, REACH	3-5 Vite Garanci, CE, RoHS, REACH, ENERGY STAR	I PLOTËSUAR

2. Krahاسimi i Funksioneve Softuerike të Ekosistemit SMART me specifikimet e TENDERIT

Pajisja **GX V4 Plus** përfshin paketën **SMART Ink**, **SMART Notebook (Desktop)** dhe **Lumio by SMART (Cloud)**, të cilat mbulojnë të gjitha kërkesat e arsimit:

A. Në Android Integrated OS (Në Tabelë)

- **Profilitet Local / Multi-User (7 1 Admin):** Me Google EDLA në Android 14, lejohet krijimi i profilsve vendore ose kyçja e mësuesve me llogaritë e tyre (Google/Microsoft), ku secili mësues sheh vetëm aplikacionet, Google Drive/OneDrive, dhe skedarët e tij personalë.
- **Split Screen & Overlay (Shkrimi sipër çdo gjëje):** Funksioni i integruar me meny anësore (Sidebar/Toolbar) lejon punën në dy aplikacione paralelisht (*Split Screen*) dhe shkrimin sipër çdo burimi hyrës (HDMI, VGA, DP) ose aplikacioni përmes **SMART Ink Overlay**.
- **Screen Record, Screenshots & Widgets:** Të integruara në meny (përfshijnë Stopwatch, Timer me alarm, Voting Kit me QR code për përgjigje të shpejta).
- **Screen Share simultan:** Mbështet ndarjen e ekranit deri në 7 pajisje të nxënësve pa kufizim kohor, duke lejuar ndërveprimin dypalësh.

B. Në Softuerin Desktop (SMART Notebook & SMART Ink)

- **Reformatimi i Matematikës & Handwriting to Text:** Konverton shkrimin e dorës në font kompjuterik (p.sh., Arial) dhe zgjidh e shfaq formulat matematikografike.
- **Përmbytja 3D & Mjetet Arsimore:** Zotëron bibliotekë me objekte 3D (Biologji, Astronomi, Gjeografi, Matematikë), lojëra interaktive (si Shah), Spinner (Rota e fatit), Randomizer dhe Timers.
- **Regjistrimi i Mësimi (Audio Ekran): SMART Recorder** regjistron zërin e arsimtarit dhe të gjitha hapat e spjegimit në ekran për t'u ruajtur si video (.mp4/.avi) dhe për t'u shpërndarë te nxënësit.
- **Shkrimi brenda skedarëve (Office / Web / PDF):** Përmes **SMART Ink®**, shënimet ruhen **drejtpërdrejt brenda skedarit** Word, Excel, PowerPoint ose PDF, dhe jo vetëm si Simple Screenshot.

C. Në Cloud / Web Platform (Lumio & SMART Exchange)

- **Kuizet, Sondazhet & Vlerësimi ne Excel:** Përmes **Lumio (by SMART)**, mësuesi gjeneron **QR Code / Class ID**. Nxënësit hyjnë nga çdo pajisje (iOS, Android, Windows, MAC) pa instaluar aplikacion.
- **Sfidat me Buzzer, Puna në Grupe dhe Voting Kit:** Përfshin formatet *Game Show*, *Monster Quiz* (me Buzzer dhe matje kohe për grupe) dhe pyetje me zgjedhje A, B, C, D ku rezultatet eksportohen automatikisht në skedar **Excel (.xlsx)**.
- **Shkëmbimi Global i Mësimeve:** Qasje direkte në **SMART Exchange** (exchange.smarttech.com) ku mësuesit mund të shkarkojnë ose të ngarkojnë

mësimet të kategorizuara sipas lëndës dhe klasës.

Përfundim & Verdict

Ndryshe nga modelit standard GX175 V2, produkti i ri **SMART Board GX V4 Plus**:

1. **E plotëson 100% pjesën Hardware:** Ka specifikat e kërkuara si **Android 14 me Google EDLA, 8GB RAM, 64GB Storage, 40 pika touch**, dhe portën **USB-C me 65W/100W Power Delivery**.
2. **E plotëson 100% pjesën Softuerike:** Ekosistemi **SMART Notebook SMART Ink Lumio** i mbulon të gjitha kërkesat e tenderit për matematikën, modulën 3D, shkrimin mbi dokumente Office/PDF, kuizet me QR Code/Buzzer, regjistrimin e orës dhe platformën Cloud.

Përfundim: SMART Board GX V4 Plus (75") i plotëson plotësisht të gjitha specifikat teknike të këtij tenderi.

Prezantimi i Tables Interaktive, Paisjeve të vijueshmërisë (QR Code) dhe Software-it të ofruar

Në kërkesën për rishqyrtim kemi ngritur pretendimin se kërkesa e Autoritetit Kontraktues për **prezantimin fizik të tabelës interaktive, paisjeve të vijueshmërisë me QR Code dhe software-it të ofruar** është një kërkesë artificiale, joproporcionale, diskriminuese dhe në kundërshtim flagrant me parimet themelore të prokurimit publik.

Kjo kërkesë është e papranueshme sepse:

-
- Një **System Integrator** profesional nuk mban stoke fizike të produkteve të specializuara (tabela interaktive software specifik paisje vijueshmërie). Vetëm një operator ekonomik që **ka tashmë në stok** këto produkte (me shumë gjasa produkte origjinale SMART) mund ta plotësojë këtë kërkesë pa vështirësi.
-
- Kjo tregon se Autoriteti Kontraktues ka pasur **informacion paraprak preferencial** nga një OE i caktuar, duke i dhënë atij avantazh të padrejtë ndaj të gjithë konkurrentëve të tjerë.
-

Me këtë kërkesë, AK ka krijuar një barrierë artificiale që **eliminon de facto konkurrencën**, duke favorizuar një OE të vetëm që ka mostra të gatshme. Kjo përbën shkelje të rëndë të:

- **Nenit 7 LPP** (Barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi);
- **Nenit 6 LPP** (parimi i proporcionalitetit dhe efikasitetit ekonomik);
- **Nenit 28 LPP** (ndalimi i specifikimeve diskriminuese);

- Parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive.

Vendimi i AK-së është plotësisht i pamjaftueshëm dhe i paarsyetuar. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë justifikim teknik apo ligjor pse kërkohet prezantimi fizik paraprak i mostrave, as nuk ka sqaruar si mund ta plotësojë një operator normal (pa stok) këtë kërkesë pa u diskriminuar. AK ka injoruar plotësisht pretendimin tonë, duke mos dhënë asnjë analizë mbi pasojat diskriminuese të kësaj kërkesë.

Kjo praktikë nuk ka të bëjë me nevoja reale të prokurimit, por me favorizim të një operatori ekonomik të paracaktuar. Kërkesa për mostra fizike mund dhe duhet të bëhet pas lidhjes së kontratës (si mostër kontraktore), jo si kusht paraprak për pjesëmarrje në tender.

TUTJE: Edhe ky pretendim i yni si OE - tani më publikimin e "Procesverbali i Hapjes së Tenderit", është i vertetuar 100% :

GOE - Pretendent për me u shpall fitues :

GOE: KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A. & SolvIT SH.P.K.

Nese hymë në webfaqen e KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A.

<https://kit-ks.com/products/>

Shohim se OE - i ka të gatshëm dhe të publikuar software-et e kërkuar nga AK :

- 1. Software Platform for managing Educational processes**
- 2. Time and attendance recording devices**

Sikurse dhe Hardware - i, sigurohet nga partneri në konsorcium SolvIT SHPK, që rrjedhimisht plotësojnë kërkesen e AK.

Kërkesat Profesionale dhe Teknike janë joproporcionale, artificiale dhe favorizuese ndaj një OE të caktuar (Shkelje e Nenit 6, Nenit 51 dhe Nenit 7 të LPP-së)

Autoriteti Kontraktues ka vendosur një seri kërkesash profesionale që nuk kanë lidhje reale me nevojat objektive të projektit, por duken të hartuara me qëllim për të kufizuar konkurrencën dhe për të favorizuar një operator ekonomik të paracaktuar.

Kërkesat problematike janë si vijon:

1. **Menaxher i Kontratës** – Kërkohet certifikim ITIL ose Prince 2 pa asnjë justifikim se pse këto certifikime specifike janë të domosdoshme për këtë projekt. Kjo kërkesë është e paqartë dhe diskriminuese.
- 2.
3. **Arkitekt i Sistemit** – Forma e kërkesës për CV është e tillë që favorizon OE që kanë staf të gatshëm me profile të përshtatura.
- 4.
5. **Ekspert i Sigurisë Kibernetike** – Kërkesa është krejtësisht jashtë fushës së projektit. Certifikimet e kërkuara (përfshirë Malware Reverse Engineering dhe IPv6 Security) janë tepër specifike dhe të larta për një projekt digitalizimi shkollor. Edhe pse AK thotë “ose ekuivalente”, kombinimi i tyre krijon një barrierë reale.
- 6.
7. **5 Zhvillues Software** – Përcaktimi i numrit të saktë “5” është arbitrar, joprofesional dhe joproporcional. Nuk ekziston asnjë arsye teknike pse pikërisht 5, e jo 4 ose 6. Kjo kërkesë sugjeron se AK di paraprakisht se cili OE ka saktësisht këtë numër zhvilluesish të disponueshëm.
- 8.
9. **Teknikë të Certifikuar për Instalim të SMART Board-ve dhe Trajnuese për Përdorim të SMART Board-ve** – Këto kërkesa janë veçanërisht të rënda sepse lidhen drejtpërdrejt me një **brand specifik (SMART TECHNOLOGIES)**. Vetëm operatorët që kanë marrë trajnim zyrtar nga ky prodhues mund t'i plotësojnë lehtësisht. Kjo provon qartë favorizim ndaj një OE që punon me këtë markë.

Këto kërkesa shkelin rëndë:

- **Nenin 6 LPP** (parimi i proporcionalitetit dhe ekonomicitetit);
- **Nenin 51 LPP** (kriteret objektive të përzgjedhjes);
- **Nenin 7 LPP** (barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi).

Vendimi i AK-së në këtë pikë është i pamjaftueshëm dhe jo bindës. Autoriteti Kontraktues kufizohet në pohime të përgjithshme se “kërkesat janë objektive dhe proporcionale”, pa dhënë asnjë analizë të detajuar teknike, pa justifikuar numrat dhe certifikimet specifike, dhe pa vlerësuar ndikimin e tyre në konkurrencë.

Kjo qasje nuk mbron interesin publik, por krijon kushte preferenciale për një OE të vetëm.

Brazuar në të gjitha shkeljet e mësipërme të Neneve 6, 7, 28, 69 dhe 108/A të LPP-së, i kërkojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së:

Të anulojë Vendimin e AK-së të datës 17.07.2026 (Prot. Nr. 32 të dt. 20.07.2026). (i publikuar me dt. 20.07.2026.)

Të obligojë Autoritetin Kontraktues (Komuna e Fushë Kosovës) që të **përmirësojë Dosjen e Tenderit** duke eliminuar specifikimet teknike patentuara të *SMART Technologies* dhe specifikat tjera që favorizojnë BRAND ose prodhues të caktuar, të reduktojë kriteret disproporcionale të stafit (të jenë të matëshme dhe reale konformë projektit dhe nevojave të projektit) dhe qarkullimit financiar, dhe të kthejë lëndën në rishqyrtim me afat të zgjatur për ofertim.

- Praktika e Organit Shqyrtues të Prokurimeve është e konsistencuar në anulimin e vendimeve të Autoritetit Kontraktues kur specifikimet teknike favorizojnë një prodhues të caktuar (neni 28 LPP) ose kur kriteret profesionale janë joproporcionale (neni 6 dhe 60 LPP). Në raste të ngjashme OSHP ka urdhëruar pezullimin e procedurës, anulimin e vendimit dhe riformulimin e dosjes së tenderit për të garantuar konkurrencën e lirë dhe efektive.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Veprimet e kundërligjshme të Autoritetit Kontraktues (Komuna e Fushë Kosovës), përmes hartimit të specifikimeve teknike diskriminuese që korrespondojnë 100% me një prodhues të caktuar (SMART Technologies) dhe caktimit të kriterëve disproporcionale për staf dhe qarkullim financiar, i shkaktojnë OE-së tonë dëm të drejtpërdrejtë material, operativ dhe ekonomik si më poshtë:

Humbja e Fitimit të Pritshëm (Minimumi 30% e vlerës së projektit): Eliminimi apo pamundësimi i jashtëligjshëm i OE-së tonë për të garuar me kushte të barabarta në këtë aktivitet prokurimi me vlerë të parashikuar prej 900,000.00 €, na privon nga e drejta ligjore për realizimin e fitimit të arsyetuar afarist. Bazuar në projeksionet financiare dhe strukturën e kostos për këtë projekt tre-vjeçar, fitimi i realizueshëm për OE-në tonë llogaritet në minimum 30% të vlerës totale të kontratës (së paku 270,000.00 €), i caktuar drejtpërdrejt në rrezik nga vendimi i AK-së.

Kostoja e Angazhimit Operativ dhe Burimeve Njerëzore (Së paku 30,000.00 €): Përgatitja e këtij tenderi kompleks ka kërkuar më shumë se 1 muaj punë intensive nga një ekip i tërë i angazhuar. Kjo përfshin:

Analizën e hollësishme të të dhënave teknike dhe dosjes së tenderit;

Koordinimin e vazhdueshëm me prodhuesit ndërkombëtarë dhe rrjetin e shpërndarësve (distributorëve);

Përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim prane AK-së dhe kësaj Ankesa te OSHP.

Llogaritja e orëve të punës të ekspertëve tanë tekniko-ligjore, stafit menaxhues dhe partnerëve tanë (prodhues/distributorë) përbën një dëm të drejtpërdrejtë operativ prej së paku 30,000.00 €, burime këto të çuara dëm për shkak të barrierave artificiale të vendosura nga AK.

Taksa Ankimore dhe Shpenzimet Procedurale: Për të mbrojtur të drejtat tona të garantuara me LPP, OE ynë është i detyruar të bëjë shpenzime të drejtpërdrejta financiare, përfshirë taksën ankimore për OSHP në vlerën maksimale prej 10,000.00 €, si dhe shpenzimet juridike-administrative lidhur me këtë procedurë.

Përmbledhje: Nëse Paneli Shqyrtues i OSHP-së nuk ndërhyr për të anuluar këtë vendim të AK-së dhe për të detyruar përmirësimin e Dosjes së Tenderit, OE-së tonë i shkaktohet një dëm total material dhe ekonomik prej së paku 310,000.00 € (270,000 € fitim i humbur + 30,000 € shpenzime analize/ekipi + 10,000 € taksë ankimore).

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*